



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parshtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. 09-3378/1 të 29.09.2020, formuar pas një denoncimi kundër personit zyrtar -----, dekan në fakultetin e ----- për përcaktimin e gjendjes së konfliktit të interesit, **NDËRPRITET.**

KSHPK- përcaktoi se pretendimet nga denoncimi vërtetohen, është konstatuar shkeleje e dispozitave të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit , pas së cilës do të dorëzohet Inicativë për përcaktimin e përgjegjësisë së personit -----dekanë në fakultetin e ----- deri te organi kompetent.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 09-3378/1 të datës 29.09.2020 është formuar pas denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur kundër personit -----, dekanit të Fakultetit të ----- dhe gruas së tij -----, profesor në të njëjtën fakultet, me pretendime se në të njëjtin fakultet është regjistruar djali i tyre ----- i cili për shkak të mbrojtjes së papërkohshme të tezës së masterit e ka zgjeruar afatin për një vit, ndërsa udhëheqës i Këshillit të ciklit të dytë ishte nëna e tij.

Në drejtim të gjendjes faktike në rastin konkretë, KSHPK kërkoi që të kryhet një mbikëqyrje e jashtëzakonshme Fakultetit të ----- nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, pas së cilës është përcaktuar:

Fakultetit të ----- në Universitetin ----- në ditën e mbrojtjes së tezës së masterit të studentit ----- prindërit e tij morën pjesë si mysafirë, d.m.th. ndëgjues dhe procedura për mbrojtjen e tezës së masterit u krye në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin dhe studimin e studimeve të ciklit të dytë në këtë Universitet.

Më 22 tetor 2021, u dorëzuan dy deklarata, domethënë: -----, profesor i rregullt dhe dekan i -----, babai i kandidatit dhe -----, profesor asistent i -----, nëna e kandidatit (para se të ishte

kreu i ciklit të dytë të studimeve dhe i njëjti dha dorëheqjen më 23 dhjetor 2019) se ata të dy morën pjesë në mbrojtjen e tezës së masterit të ----- vetëm si mysafirë, d.m.th. dëgjues.

Përveç mbikëqyrjes së jashtëzakonshme të kryer nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Komisioni Shtetëror ka marrë dokumentacion nga Fakulteti për -----, pas së cilës është përcaktuar se:

Në seancën e 106-të të Këshillit shkencorë të shkollës të ----- të mbajtur më 27.08.2020, të udhëhequr nga Dekani -----, pika e katërt e rendit të ditës ishte: "Shqyrtimi i kërkesës së ----- dhe miratimi i Vendimit për krijimin e Komisionit për vlerësimin e tezës së masterit me titull "Zhvillimi i shërbimeve web për menaxhimin e objekteve 2D me formë të parregullt dhe teksturë jo homogjene". Gjatë shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, u mor Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e temës së magjistraturës ----- . Dekani nuk ka raportuar se kjo pikë e rendit të ditës i referohet një personi të afërt, ai nuk është justifikuar dhe ka nënshkruarë procesverbalin e kësaj seance.

Në seancën e 107-të të Këshillit shkencor të shkollës-----, e mbajtur më 17.09.2020, i drejtuar nga Dekani i -----, në të cilën pika e 10-të e rendit të ditës është "Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Vlerësimit të Tezës së Masterit nga kandidati ----- dhe formimi i Komisionit të Mbrojtjes dhe përcaktimi i datës së mbrojtjes.". Gjatë shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, u mor Vendim me të cilin miratohet Raporti i Komisionit për Vlerësimin e Tezës së Masterit nga kandidati ----- dhe u formua Komisioni për Mbrojtjen e Masterit teza e të njëjtit kandidat. Ashtu si në seancën e kaluar, dekani nuk ka raportuar se është person i afërt, është justifikuar dhe ka firmosur procesverbalin e kësaj seance.

Në nenin 73 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit u parashikua si më poshtë:

(1) Nëse personi zyrtar merr pjesë në debatin e organit ose trupit ku vendoset për punët për të cilat ai ose personi i afërt ka interes publik, personi zyrtar obligohet ta paraqesë ekzistimin e interesit publik dhe të përjashtohet nga debati dhe vendimmarrj

(2) Organi ose trupi në mbledhjen e të cilit personi nga paragrafi (1) i këtij neni e ka kumtuar ekzistimin e interesit privat obligohet që ta konstatojë dhe ta vendosë atë në procesverbal.

(3) Ndërprerja e ekzistimit të interesit privat nga personi zyrtar parqet shkelje të detyrës dhe bazë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë dhe shqiptimin e masave në pajtim me këtë ligj.

Gjithashtu në pajtim të nenit 75 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e korrupsionit:

(1) Kur personi zyrtar do të dijë për rrethanat që sugjerojnë në ekzistimin e konfliktit të interesave ose të konfliktit potencial të interesave, ka për detyrë menjëherë të kërkojë të përjashtohet dhe të ndërpresë veprimin e vet.

Në nenin 2 paragrafi 3 të të njëjtit ligj është definuar gjendja e konfliktit të interesit:

(3) Me konflikt të interesave nënkuptohet gjendja në të cilën personi zyrtar ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi kryerje të paanshme të autorizimeve të tij publike ose detyrave zyrtare.

Respektivishtë, personi zyrtarë ----- dekan në Fakultetin e -----nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e cituar më lartë nga ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit , gjegjësishtë ka bër shkelle të nenit 73 paragrafi 1 dhe nenit 75 paragrafi 1 nga i njëjti ligj. Personi zyrtarë ka marrë pjesë në diskutimet e një organi në të cilin janë marrë vendime për çështje në të cilat një person i afërt i tij ka pasur interes privat, pas së cilës ai nuk ka raportuar dhe nuk është shfajësuar para diskutimeve dhe vendimmarrjes, duke udhëhequr kështu në një gjendje konflikti interesash.

Për këtë në seancën e 72-të KSHPK-së u vendosë që në përputhje me nenin 17 pika 4 të LPKKI-së do të paraqesë Iniciativë për përcaktimin e përgjegjësisë së personit -----, dekan i Fakultetit të ----- ---, Këshillit shkencorët të shkollës pranë Fakultetit ----- si autoritet kompetent që e ka zgjedhur këtë person për shkak të gjendjes së konstatuar të konfliktit të interesit në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tij publike. Pas dorëzimit të iniciativës për përcaktimin e përgjegjësisë ndaj personit ----- te organi kompetent, KSHPK-ja do të ndërpresë procedurën në lëndën me nr. 09-3378/1 datë 29.09.2020 , për arsye se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme kompetente.

Duke pasur parasysh të theksuaren e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetarë,
Nuri Bajrami

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Përgatiti: K.Z., Udhëheqës
Miratoi: M.r.SH.S, Anëtar i KSHPK-së